



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, dhe
Peticione**

P-nr.15/2021

Prishtinë, më 29.6.2021, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Tinka Kurti, Albana Bytyçi, Vafrije Krasniqi, Alban Bajrami, Fjolla Ujkani, Ariana Musliu -Shoshi, Eliza Hoxha dhe Milosh Peroviç.

Munguan: Duda Balje, Saranda Bogujevci dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Rushiti- D+, Emir Abrashi-D+, Ivan Radojeviq-WFD, Dragica Reljanoviç- WFD, Prof. Dr. Maria Mosmouth – Instituti i Studimeve të Avancuara Ligjore të Universitetit të Londrës (IALS), bashkëpunëtore e Fondacionit Westminster për Demokraci WFD, pjesëmarrëse përmes platformës Zoom, Elena Elshani-praktikante, Durim Elshani-GP, Arbresh Asllani-GP LVV dhe Ismet Mahmuti-Zyra e Mediave Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Tinka Kurti, nënkryetare e parë e komisionit.

Rendi i ditës

1. Takim në Komision lidhur me prezantimin e Raportit të shqyrtimit post-legjislativ të

të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Të ftuar: Përfaqësuesit e Organizatës Britanike Fondacioni Westminster për Demokraci / Westminster Foundation for Democracy WFD.

Kryesuesja, fillimisht përshëndeti Përfaqësuesit e Westminster Foundation for Democracy WFD, organizatë kjo e cila mbikëqyr dhe koordinon funksionimin dhe punën e Rrjetit të Komisioneve Parlamentare për të Drejtat e Njeriut dhe të Barazisë Gjinore të shteteve të Ballkanit Perëndimor, që njihet me emërtimin HUGEN.

Ajo theksoi se në kuadër të këtij aktiviteti, do të bëhet prezantimi i analizës post legjislative për Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, të iniciuar vitin e kaluar nga Komisioni Funkcional, në kuadër të Rrjetit HUGEN.

Më pas, ajo ia dha fjalën përfaqësuesit të Westminster Foundation for Democracy, për të paraqitur aktivitetet dhe fushëveprimin e Rrjetit HUGEN.

Ivan Radojeviq, falënderoi anëtarët e komisionit për mundësinë që ia kanë dhënë për prezantimin në emër të Rrjetit të komisioneve për të drejtat e Njeriut dhe të Barazisë Gjinore të Ballkanit Perëndimor. Ky rrjet është krijuar në tetor të vitit 2019, si një platformë joformale për shkëmbimin e përvojave, njohurive të praktikave më të mira dhe të ideve, ndërmjet parlamenteve të Ballkanit perëndimor, që ndryshe njihet me emrin HUGEN. Ky rrjet përbëhet nga tetë parlamente të Rajonit dhe në total ky rrjet ka 15 komisione të ndryshme, që kanë në kompetencë fushën e të drejtave të njeriut dhe të barazisë gjinore.

Ai në pika të shkurtra paraqiti aktivitetet e këtij Rrjeti, që nga themelimi e deri më tani.

Radojeviq tha se që nga shkurti i vitit 2020, është vendosur që të gjitha parlamentet pjesëmarrëse të zgjedhin një pjesë të ligjeve të tyre që do të jenë pjesë e procesit të shqyrtimit post-legjislativ. Ky proces, me Kuvendin e Kosovës, respektivisht me Komisionin e juaj, në mënyrë zyrtare ka filluar në tetor të vitit 2020, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi është zgjedhur dhe është propozuar nga vet komisioni juaj që të kalojë nëpër modelin e shqyrtimit post-legjislativ.

Ai tha se shpreson që pas përmirësimit të situatës nga Covid 19, në shtator apo tetor, të keni mundësi të diskutoni ballë përballë për punën të cilën e kanë bërë edhe parlamentet e tjera në kuadër të këtij pilot projekti.

Kryesuesja, falënderoi z.Radojevoiq, për njoftimin që e bëri për anëtarët e komisionit dhe paraqitjen e planeve në emër të rrjetit, dhe tha se si komision janë të interesuar për bashkëpunim për zbatimin sa më të mirë të këtij ligji për të cilin është bërë analizë.

Maria Mosmouhi, tha se i ka përcjell aktivitetet e këtij rrjeti që nga momenti i themelimit dhe se po i testojnë metodologjitë dhe se ka rezultate të prekshme dhe po i përmirësojnë praktikat e tyre, jo vetëm në aspektin individual të parlamenteve por edhe në atë rajonal.

Janë shkëmbyer shumë njohuri dhe është e rëndësishme për institucionet tona dhe për praktikat post legjislative që të kemi metodologji të reja.

Ajo tha se ka punuar me Westminster Foundation for Democracy WFD, në disa raste dhe projekte të ndryshme.

Më tej shtjelloi prezantimin e saj për shqyrtimin post-legjislativ, duke thënë se tradicionalisht çka parlamentet kanë bërë, është miratimi i ligjeve dhe gjatë dekadave të fundit diçka është shtuar në detyrën e tyre, pra, parlamentet nuk e kanë rolin vetëm në miratimin e ligjeve, por roli i tyre është që të sigurohen që ligjet të jenë cilësore, të sigurohen që ligjet të kenë ndikim në jetën e njerëzve dhe kjo pak e zhvendos fokusin nga indikatorët sasiorë në atë se sa ligje kanë bërë ndryshim në vend dhe në jetën e njerëzve. Pra parlamentet kanë një rol gjatë tërë procesit legjislativ, pas hyrjes në fuqi të ligjit, është edhe një fazë tjetër që është mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe ky proces është aktualizuar kohëve të fundit më shumë.

Janë katër arsye pse ligjet kanë nevojë që të analizohen kohë pas kohe edhe pas miratimit.

Arsyeja e parë ka të bëjë me qeverisjen demokratike, arsyeja e dytë është se e vetmja mënyrë për të parë se sa një ligj është efektiv, të kthehemi prapa dhe të shikojmë si është zbatuar.

Arsyeja e tretë është se ligjet miratohen për të arritur një rezultat të caktuar dhe arsyeja e fundit pse duhet të shqyrtohen ligjet kohë pas kohe, është që duhet të testohet kualiteti i tyre.

Shqyrtimi ex ante dhe ex post nuk janë të izoluar njëra me tjetrën, janë pjesë e të njëjtës monedhë dhe është shumë me rëndësi që këto të dyja të trajtohen si të tilla.

Shqyrtimi ex post, është një ushtrim i strukturuar i grumbullimit të informatave se si ligjet janë implementuar, mund të përqendrohet në zbatimin e ligjit a ka nevojë të miratohen akte nënligjore. Këto pyetje lidhen më shumë me zbatimin apo mund të flasim për ndikimin e ligjit në grupe të ndryshme, të njerëzve dhe për rezultatet e arritura, apo mund të shikohen të dyja këto.

Ajo, në vazhdim paraqiti edhe aspekte të tjera të kontrollit post-legjislativ të ligjeve.

Më pas, fjalën ua dha përfaqësuesve të organizatës Demokracia plus, e cila ka qenë e angazhuar nga WFD për të bërë analizën post-legjislative të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Emir Abrashi, tha se shqyrtimi post legjislativ i Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi është bërë sipas rregullave të WFD-së, me kërkesë të Komisionit Funkcional të Kuvendit të Kosovës.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ka hasur në pengesa në zbatim dhe në 5 vitet e fundit është shënuar përparim i vogël sa i përket zbatimit të këtij ligji. Raporti është hartuar duke zhvilluar intervista me palë të interesit, kryesisht me Institucionin e Avokatit të Popullit, Ministrinë e Drejtësisë, Agjencinë për Barazi Gjinore, Zyrën për Qeverisje të Mirë, Zyrën Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si dhe Iniciativën e të Rinjve për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, zyra në Prishtinë.

Nga këto intervista është parë se ka mungesë të përgjithshme të ndërgjegjësimit për ligjin, në publikun e gjer si dhe në gjyqësor, përgjigjet e marra nga palët e lartpërmendura të interesit, janë se ligji në përgjithësi është i shkruar mirë, i përmbush standardet evropiane, pasi që edhe në hartimin e këtij ligji ka qenë i përfshirë edhe Komisioni Evropian dhe nuk kërkon ndonjë ndryshim në këtë fazë, megjithatë kërkohet ndërgjegjësim i publikut për këtë ligj e si rrjedhojë të identifikohen sfidat në zbatimin e ligjit.

Ky raport i shqyrtimit post-legjislativ rekomandon që Institucioni i Avokatit të Popullit, të forcohet si financiarisht ashtu edhe me burime njerëzore.

Gjithashtu Zyra për Qeverisje të Mirë, duhet të vazhdojë mbikëqyrë zbatimin e ligjit dhe t'i forcojë përpjekjet e veta për të rritur ndërgjegjësimin në publikun e gjerë për rendësinë e këtij ligji.

Procesi i hartimit të këtij raporti është bërë sipas metodologjisë së paraparë nga Westminster Foundation for Democracy. Ligji për mbrojtje nga diskriminimi nuk ka pasur zbatim të kënaqshëm, ndërsa Ligji për Avokatin e Popullit dhe Ligji për Barazi Gjinore, që janë pjesë të njëjtës pako, kanë pasur zbatim të kënaqshëm, sipas të dhënave të zyrës së Kryeministrit.

Gjetjet nga ky studim tregojnë se ligji është i hartuar mirë, por nuk gjen zbatim në praktikë dhe gjetjet tregojnë se nuk është e nevojshme ky ligj të ndryshohet, por të mundohemi që të përqendrohemi më shumë te vetëdijesimi për ekzistimin e këtij ligji te publiku dhe aktorët gjyqësorë dhe në fund paraqiti rekomandimet nga ky raport.

Kryesuesja, falënderoi për prezantimin dhe tha se e vlerëson si një raport të duhur dhe se është e rëndësishme që ky raport të shpërndahet edhe nëpër institucionet e tjera. Promovimi i çdo ligji është i obligueshëm por, ligjet që prekin drejtpërdrejt të drejtat e njeriut pothuajse në të gjitha vendet sikur e kanë një trajtim të dorës së dytë.

Kryesuesja Tinka Kurti, pyeti në lidhje me çështjen e komentarit të mundshëm për këtë ligj dhe se a mund të parashihet ndonjë formë tjetër e aktiviteteve, si trajnime për gjykatat lidhur me këtë rast.

Visar Rushiti, tha se në njërën prej rekomandimeve është cekur se është mirë të kemi një sqarim, komentim pak më shumë se ajo që shkruhet në ligj. Patjetër ajo që ju po sugjeroni është një prej aktiviteteve që mund të bëhet në të ardhmen, mirëpo, për këto duhet të jete nisma nga iniciuesi i ligjit që është Zyra për Qeverisje të Mirë.

Emir Abrashi, tha se komentari më shumë vlen për punën e gjyqësorit, që trajtojnë lëndët që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Fjolla Ujkani, pyeti se çfarë diskriminimi është vërejtur gjatë analizës e që është më i theksuar në shoqërinë tonë, sepse ka diskriminime të ndryshme, por atë që ju e keni parë më shqetësuese dhe që duhet të trajtohet më me prioritet?

Ivan Radojeviq, tha se Parlamenti duhet ta përmirësojë marrëdhënien me Institucionin e Avokatit të Popullit. Kemi zgjedhur rekomandimet që kanë të bëjnë me parandalimin e diskriminimit, dhe nuk ka pasur shumë raste të diskriminimit në raportet që ata i kanë gjetur.

Visar Rushiti, tha se për shkak të situatës me pandeminë nuk kanë pasur mundësi të dalin me shumë në terren për t'i pyetur qytetaret se ku hasin më shumë në diskriminim, apo në çfarë lloji, por më shumë jemi kufizuar në takime, të shumtën e rasteve online me institucionet publike. Nuk kam përgjigjeje konkrete se cilat lloje të diskriminimit janë më të theksuara.

Albana Bytyqi, pyeti se a mendoni se vajzat e mbuluara janë raste të diskriminimit sa i përket punësimit në Kosovë?

Visar Rushiti, tha se vajzat që bartin mbulesë janë të diskriminuara sidomos në aspektin e punësimit, por është evidente dhe ndodh në vazhdimësi.

Tinka Kurti, tha se ishte e rëndësishme ajo për t'i zgjeruar kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit, por kjo duhet të bëhet përmes amendamentimit të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Visar Rushiti, tha se kjo pjesë rregullohet me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe me këtë janë të limituar të pranojnë ankesa nga ky sektor, ndërsa ligji nga diskriminimi e ka fushëveprimin më të gjerë.

Kryesuesja, falënderoi mysafirët për pjesëmarrjen, prezantimet dhe shtjellimin e tematikës që bënë para anëtarëve të komisionit.

Në fund, kryesuesja Tinka Kurti, njoftoi se anëtarët e komisionit, bashkë me mysafirët do të kenë një drekë të përbashkët në Restorantin Rings, në Prishtinë, në orën 12:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda Balje,
Kryetare e Komisionit